

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Per Aktivitetin:

MINIERE NENTOKESORE

PER SHFRYTEZIM BAKRI

ZONA MINERARE NR.275/9, OBJEKTI GURTH 3

Vendodhja : Nj.Ad. Fan dhe Orosh, Bashkia Mirdite, Qarku Lezhe.

Kërkues: "Tete Albania Tunel & Mining" sh.p.k.


Referuar shtojces: (sipas ligjit 10440 shtojca II pika 2.2)

Hartoi raportin:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k


Administrator

Elidiana Shehu




Altin Ahmeti

(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)



Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)



Dhjetor, 2018

Permbajta e Tabeles

1.	HYRJE.....	3
2.	PERSHKRIMI I PROJEKTIT.....	4
2.1	Pershkrimi i Qellimit te Projektit.....	4
2.2	Planimetria e vendodhjes se Projektit	4
2.3	Skicat dhe Planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit.....	7
	<i>Figura 4: Harta gjeologo – topografike me rruget dhe sheshet e depozitimit te sterileve.....</i>	<i>7</i>
	<i>Figura 5: Planimetria e pergjithshme e punimeve.....</i>	<i>8</i>
2.4	Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike, kapacitet prodhuese / perpunuese, lendet e para, produktet perfundimtare	9
2.4.1	Zgjedhja dhe pershkrimi i sistemit te shfrytezimit	9
2.4.2	Varjanti i propozuar i hapjes dhe shfrytezimit te objektit.....	9
2.4.4	Ajrimi gjate hapjes se punimeve kapitale dhe rampes.....	11
2.4.6	Kapaciteti prodhues dhe jeta e minieres.....	12
2.4.7	Percaktimi i vendit te depozitimit te mineralit, llogaritja e kapacitetit depozitues:	12
2.4.8	Percaktimi i vendit per depozitimin e sterileve, llogaritja e kapacitetit depozitues	12
2.4.9	Ajrimi i minieres.....	13
2.5	Infrastruktura e nevojshme per realizimin e projektit.....	14
2.6.	Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe sigurimi i tyre(materiale ndertimi, uje, energji) 14	
2.7.	Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate lidhur me vendodhjen.....	15
2.8.	Perdorimi i lendeve te para gjate funksionimit te aktivitetit dhe menyra e sigurimit te tyre	15
4.	PERSHKRIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR.....	16
4.1.	Ndikimet negative ne mjedis gjate fazes se hapjes se galerive (pergatitore).....	16
4.1.1.	Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit.....	16
4.1.2.	Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit.....	16
4.1.3.	Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve	16
4.1.4.	Ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit, dhe peisazh si mineralet, pyjet, burimet ujore.....	17
4.1.5.	Ndikimet sociale te projektit, ndryshimi i perdorimit te tokes, ndikimet nga zhurmat, pluhuri, perdorimi i burimeve natyrore	17
4.2.	Identifikimi i ndikimeve negative ne mjedis gjate fazes se shfrytezimit.....	17
4.2.1.	Ndikimet e mundshme mjedisore ne nentoke dhe proceset sipërfaqësore të tokës	17
4.2.2.	Ndikimet e mundshme negative ne ajer	18
4.2.3.	Ndikimi ne biodiversitet	18
4.2.4.	Ndikimet e mundshme negative ne ujera.....	18
4.2.5.	Ndikimet ne shendetin e punonjesve	18

5.	NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT.....	19
6.	MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS	20
6.1.	Masat për zbutjen e ndikimeve gjatë fazës përgatitore dhe shfrytezimit te galerive nentokesore.	20
6.2.	Masat për sigurimin teknik ne pune	20
7.	MONITORIMI MJEDISOR	22
7.1.	Programi i monitorimit.....	22

Tabelat

<i>Tabla 1: Koordinatat e zonës për të cilën kërkohët leje shfrytëzimi.....</i>	<i>5</i>
---	----------

Figurat

<i>Figura 1: Pozicioni I zones minerare Gurth 3 ne lidhje me ndarjen administrative.</i>	<i>5</i>
<i>Figura 2: Pozicioni I zones minerare Gurth 3 ne lidhje me zonat e banuar.....</i>	<i>5</i>
<i>Figura 3: Pozicioni I zones minerare Gurth 3 ne harten topografike.....</i>	<i>6</i>
<i>Figura 4: Harta gjeologo – topografike me rruget dhe sheshet e depozitimit te sterileve.....</i>	<i>7</i>
<i>Figura 5: Planimetria e pergjithshme e punimeve</i>	<i>8</i>
<i>Figura 6: Planimetria e hapjes se objekteve Gurth 3 dhe Letitna me galeri te perbashketa.....</i>	<i>10</i>
<i>Figura 7: Percaktimi I sheshit te depozitimit te sterileve.....</i>	<i>13</i>

1. HYRJE

Propozuesi i projektit, shoqëria "TETE Albania Tunnel & Mining" sh.p.k. është një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e shfrytëzimit dhe pasurimit të bakrit dhe nëpërmjet këtij projekti të paraqitur synon nxjerrjen e koncentratit të bakrit nga minerali i vendburimit Gurth 3 duke furnizuar fabrikën e pasurimit të bakrit në Sapc .

Për këtë qëllim shoqëria së pari është pajisur me njoftim fituesi Nr. 10871/2 datë 19.09.2018 për përfitimin e të drejtës për aplikimin e lejes Minerare Zona Minerare 275/9 (Objekti Gurth 3).

Pas marrjes së lejes së shfrytëzimit, shoqëria do të kryejë investimet e nevojshme për hapjen e galerive deri në trupat e mineralit të bakrit për të furnizuar kështu me kapacitet të plotë fabrikën e pasurimit të bakrit në zonë dhe dampen e sterileve .

Zona minerare Nr. 275/9, objekti Gurth 3 ndodhet në zonën administrative Orosh dhe Fan, në bashkinë e Mirditës, Qarku Lezhë. Vendburimi i bakrit Gurth Nr. 3 ndodhet në pjesë qendrore të Mirditës, në anën lindore të lumit të Seftes së Spaçit, në afërsi të Repsit, rreth 9 km larg tij. Në veri të tij ndodhet vendburimi Gurth 4 kurse në jug të tij ndodhet miniera e Spaçit. Vendburimi shtrihet në shpatin malor Koder Spaç - Plakëz, me drejtim gjatësor dhe nderpritet nga disa lugina perrenjsh të vegjël, me shtrirje gjerësore.

Historikisht, prodhimi i realizuar në këto zona minerare është nënshuar pasurimit për shkak të përmbajtjes së ulët të bakrit. Xehërori i vendburimit të Spaçit përmban mineralin e kalkopiritit dhe një sasi relativisht të vogël të mineralit të piritit dhe, është lehtësisht i pasurueshëm për prodhimin e koncentratit të bakrit.

Kapaciteti vjetor nxjerrës do të jetë rreth **30 000 ton/vit** mineral bakri e zinku dhe zgjidhja e sistemit të shfrytëzimit në këtë minierë do të jetë me shembje nenkati. Sipërfaqja e zonës minerare do të jetë **0.680 km²**

Duke qenë se kemi të bëjmë me një vendburim me ndryshime të theksuara të pozicionit hapsinor, pasi ndryshon rënia ,e trupave nga lindore në perëndimore, terreni ku është vendosur zona minerare është bere e mundur që punimet kapitale të hapjes cilado qofshin ato të mund të hapen në pjesën perëndimore të zonës , pasi terreni nga perëndimi në lindje vjen duke u ngritur e për pasojë zvogëlohet mundësia që minierat të hapet nga lindja. Punimet kryesore të hapjes do të nisnin në pjesën perëndimore të masivit .

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Pershkrimi i Qellimit te Projektit

Projekti që kërkohet të zbatohet nga subjekti juridik "TETE ALBANIA TUNEL & MINING" Sh.a, ka për qëllim përgatitjen dhe shfrytëzimin e rezervave minerare në zonën minerare Nr.275/9, objekti Gurth 3, (galeri te reja) për të realizuar nxjerrjen dhe më tej përpunimin më anë të procesit të pasurimit, me perfitim të produktit për destinacion të mëtejshëm eksport.

Objekti ndodhet në zonën administrative Orosh dhe Fan, në bashkinë e Mirditës, në anën e majtë të rrugës automobilistike lokale që lidh objektet e kësaj miniere me rrugën nacionale Rrëshen -Fush Arrëz dhe qytezën e Repsit.

Hapja e minieres ka filluar mbi bazen e projektit te hartuar nga ISP te Minierave Nr.1931, te vitit 1986. Ne vitin 1989 ka filluar ndertimi i objekteve siperfaqesore dhe hapja e punimeve minerare (traverbangjeve) ne horizontet +680 dhe +760. Avancimi i tyre eshte pezulluar ne vitin 1992. Qe nga ky vit miniera eshte e mbyllur.

Shfrytezimi i kësaj miniere **me galeri te reja** është me një vlerë të madhe investimi, e ndërkohë krijon kushte optimale për rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit të mineralit të bakrit, përballë një tregu mjaft të favorshëm kur çmimi ka disa vite që është rreth trefishin e periudhës më të mirë të viteve 1970 -1990, kohë që kjo minierë ka funksionuar me kapacitet maksimal dhe tregues optimal.

Bazuar në rezervat minerare, te kësaj miniere dhe kondicionin ekonomik, ne projekt jane zgjedhur edhe trupat minerare me kushte te favorshme, me permbajtje te bakrit ne xeheror, te pranueshme per nje prodhim konkruues.

Projekti eshte ne sinkron te plote edhe me strategjine kombetare te zhvillimit te industrise nxjerrese e perpunuese ne te cilen ben pjese e ze nje peshe te madhe edhe industria e bakrit nder me te vjetrat e me tradite ne vendin tone.

Elementet e zgjedhur ne pergatitje, shfrytezim dhe pasurim te tij, jane bashkekohore, duke permiresuar menyren e shfrytezimit, rritur shkallen e mekanizimit, treguesit e nxjerrjes nga nentoka, por edhe instalimi i fabrikës së pasurimit me teknologji bashkohore, si faktor pozitiv me tej edhe ne lidhje me problemet mjedisore, per objekte te tilla pas mbylljes se aktivitetit te tyre.


Ky projekt ndikon pozitivisht edhe ne zbutjen e problemeve te mprehta sociale ne kete zone.

2.2 Planimetria e vendodhjes se Projektit

Zona minerare Nr. 275/9, objekti Gurth 3 ndodhet ne zonen administrative Orosh dhe Fan, në bashkinë e Mirditës, Qarku Lezhe. Vendburimi i bakrit Gurth Nr. 3 ndodhet ne pjese qendrore te Mirdites, ne anen lindore te lumit te Seftes se Spaçit, ne afersi te Repsit, rreth 9 km larg tij. Ne veri te tij ndodhet vendburimi Gurth 1 kurse ne jug te tij ndodhet miniera e Spaçit. Vendburimi shtrihet ne shpatin malor Koder Spaç - Plakez, me drejtim gjatesor dhe nderpritet nga disa lugina perrenjsh te vegjel, me shtrirje gjeresore.

Vetë vendburimi i Spaçit gjendet ndërmjet kuotave 650 dhe 800 m mbi nivelin e detit dhe konsiston në disa galeri nëntokësore, për të cilat do të kryhen punime për ringritjen dhe rivënien në punë të tyre.

Në këtë zonë gjenden edhe vendburime të tjera të mineralit të bakrit të cilët lokalizohen ndermjet lumit Fani i vogel dhe perroit Sefta e Spaçit.



Objekti GURTH 3 (Zona nr 275/9).

Figura 1: Pozicioni I zones minerare Gurth 3 ne lidhje me ndarjen administrative.

Sipërfaqja e licensuar për shfrytëzimin është **0.680 km²** (shih hartën në shkallën 1:25000).

Nr.	X	Y
1	44 21 700	46 42 350
2	44 21 500	46 42 700
3	44 22 900	46 43 500
4	44 23 100	46 43 100

Tabla 1: Koordinatat e zonës për të cilën kërkohët leje shfrytëzimi



Figura 2: Pozicioni I zones minerare Gurth 3 ne lidhje me zonat e banuar.

HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTE DHE KOORDINATAT E ZONES MINERARE Nr. 275/9

Shkalla 1 : 25 000




Figura 3: Pozicioni I zones minerare Gurth 3 ne harten topografike.

2.3 Skicat dhe Planimetrit e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit




Figura 4: Harta gjeologjike – topografike me rrugët dhe sheshet e depozitimit të sterilit




Figura 5: Planimetria e pergjithshme e punimeve

2.4 Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike, kapacitet prodhuese / perpunuese, lendet e para, produktet perfundimtare

2.4.1 Zgjedhja dhe pershkrimi i sistemit te shfrytezimit

Hapja e minieres ka filluar mbi bazen e projektit te hartuar nga ISP te Minierave Nr.1931, te vitit 1986. Ne vitin 1989 ka filluar ndertimi i objekteve siperfaqesore dhe hapja e punimeve minerare (traverbangjeve) ne horizontet +680 dhe +760. Avancimi i tyre eshte pezulluar ne vitin 1992. Qe nga ky vit miniera eshte e mbyllur.

Hapja e punimeve minerare ne Gurth 3, eshte parashikuar mbi bazen e te dhenave gjeologjike qe disponohenshi edhe te praktikese akumuluar nga shfrytezimi i minierave te tjera te zones Spaç-Gurth.

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion pasurimin ne fabrike dhe eksportin e koncentratit.

Kapaciteti vjetor do te jete rreth **30 000 ton/vit** mineral bakri e zinku sipas njoftimit Fitues nga MIE duke perlloritur bazuar ne rezervat e kesaj miniere nje jetegjatesi prej 11 vitesh.

2.4.2 Varjanti i propozuar i hapjes dhe shfrytezimit te objektit

Varianti i pranuar per shfrytezimin e zones minerare nr 275/9, objekti Gurth 3 konsiston ne hapjen e galerive ne siperfaqen e zones minerare 275/6, objekti Letitna. Kjo per faktin se kompania "TETE ALBANIA TUNEL & MINING" sh.a eshte shpallur fituese edhe per shfrytezimin e zones minerare nr.275/6, objekti Letitna. Ky variant favorizohet gjithashtu edhe nga fakti qe zonat minerare Gurth 3 dhe Letitna jane ne kufij me njera tjetren. Nder te tjera ky variant siguron kushte me te mira ajrimi si gjate fazes se punimeve ashtu edhe gjate fazes se shfrytezimit, ule ne menyre te konsiderueshme distancen e transportit te mineralit nga galerite per ne fabrike si edhe jo vetem qe shkurtohen gjatesite e punimeve te hapjes se galerive te zones minerare nr. 275/9, objekti Gurth 3, por behet me e lehte edhe hapja e zones minerare 275/6, objekti Letitna, pasi te njetjat galeri do te sherbejne edhe per shfrytezimin e kesaj zone minerare.




Figura 6: Planimetria e hapjes se objekteve Gurth 3 dhe Letitna me galeri te perbashketa

Sipas ketij varjanti miniera ka dy nivele qe hapen nga siperfaqja, duke u nisur nga niveli i siperm qe eshte galeri ajrimi +800 me gjatesi 320 m nga gryka e hyrjes deri ne piken G0 ku do te behet takim me traverbankun i cili do te hapet ne kuoten +760m. Pika e hapjes se galerise se ajrimit ka kordinata e meposhteme:

X = 44 22 585

Y = 46 42 646

Z = 800 m

Punimi tjetër kryesor për hapjen e minierës do të shërbejë traverbanku +760 i nisur në pikën me koordinata:

X = 44 22 485

Y = 46 42 364

Z = 760 m

Në pikën e takimit G0 të dy galerive do të bëhet degezimi i këtyre galerive për të vazhduar hapjen e tyre deri në takimin me trupat e bakrit për të dy zonat minerare, Gurth 3 dhe Letitna.

Pas takimit të të dy galerive galeria e pjerret e ajrimit do të shërbejë si e tillë dhe do të vijojë me pjerresë deri në takimin me trupin e mineralit në +760, ndërkohë që punimi tjetër i nisur nga kuota +760 do të zbrese në nivelin +720 dhe do të jetë punimi i transportit të minierës

Lidhja e punimeve të niveleve +760;+720 dhe +680 do të realizohet me rampe të nisur nga niveli i sipërm +760.

Hapja e nivelit +760 sipas aksit të thyerë, të projektuar bëhet edhe për arsye se ka të dhëna që gjatë rrugës për në trupin 53 të takojë edhe disa kapje të bera nga shpimet e koheve të fundit nga një subjekt tjetër që

ka patur jeje minerare per kete objekt. Kjo gje verehet edhe ne relacionin gjeologjik te blere nga SHGJSH si dhe harta gjeologjike e shkalles 1" 5000 bashkengjitur projektit

Sipas keti varjanti, gjatesia e galerise +800 nga hyrja deri ne objekt eshte 660 m, ndersa gjatesia e galerise +670 eshte 800 metra

Sipas ketij varjanti, i gjithë minerali i prodhuar nga te dy minierat do te transportohen direkt per ne fabriken e pasurimit nepermjete nje rruge te re me fillim fabriken deri ne nivelin e galerise +760 me gjatesi rreth 2.5 km

Po sipas ketij varjanti, distanca e transportit nga Gurthi 3 dhe Letitna per ne fabrike do te shkurtohej ndieshem, pasi i gjithë minerali i te dy minerave, do te transportohej nga e njejta rruge, duke mos harruar se transporti i mineralit nga objekti Letitna per ne fabrike do te pershkonte rruge shume me te gjate ne se nuk do te perdorte kete rruge,

2.4.4 Ajrimi gjate hapjes se punimeve kapitale dhe rampes

Gjate hapjes se rampes deri ne takimin e punimit me nivelin e pare +680 do te realizohet me ajrim artificial me ventilator te markes JET me fuqi 22 kw dhe diameter 600 mm.

Me mbritjen e rampes ne nivelin+680, punimi lidhet me oxhak ajrimi me dy seksione dhe i spostuar ne plan, pra do te hapen 2 oxhaqe ajrimi, 680-720 dhe tjetri rreth 57 m nga aksi do te vijohet me oxhakun tjeteter +720-+760 dhe do te zbatohet projekti i ajrimit artificial per gjithë minieren.

Punimet minerare te çdo niveli jane paraqitur ne planimetrine perkatese, Planimetria e punimeve te nivelit +760m, 720, +680 dhe +640.

Paralelisht me mbritjen e traverbankeve 760 dhe 680 ne pikat nga te cilat hapet rampa, puna e metejshme per hapjen e rampes mund te organizohet me dy krahet , nga larte dhe nga poshte ne nivelin+680.

Me ritmet e parashikuar rapma do te hapet ne gjithë gjatesine e saj progresivisht me uljen ne shfrytezimin dhe investimet per hapjen e saj, ne llogaritjet me Cash Flow, jane ndare ne menyre te barabarte nder vite.

Punimet minerare te niveleve qe jane te hapura do te kene seksion rreth 10.4 m2

Hapja e punimeve kapitale dhe rampes eshte teresisht e mekanizuar dhe do te perdoren makinerite e meposhteme:

- Karrele shpimi hidraulike JUMBO (Jumbo)
- Ngarkuesi nëntokësor Fadroma me kapacitet 2.5 m3
- Pompe per mbushjen e birave te minave Anfon Charge Machine
- Pompe uji DIP 65 –
- Transporti i materialit di te realizohet me Kamionë kater akse

Hapja e punimeve kapitale nga fillimi deri ne lidhjen e tyre me rampen do te realizohet me ajrim artificial me ventilatore 2x15 kw dhe diameter 600 mm.

Gjate pergatitjes per shfrytezim dhe shfrytezimit punimet e nenkateve do te lidhen me oxhaqe per rrugedalje dhe ajrim.

Eshte gjykuar qe edhe rampa e vendosur ne formacione te dyshemes se trupit te vendoset paralelisht me shtrirjen e zones ne profilin 13 per pjesen e rezervave midis niveleve +760 dhe 680, Edhe per panelin 680-

640 rampa do te vendoset po ne ate pjese te zones bakerbajtese, pothuaj paralelisht me shtrirjen e trupit te bakrit. E pozicionuar ne dyshemene e trupit, ky punim, rampa do te jete edhe nje punim kerkimi, pasi gjate hapjes se saj verifikohet me mire zona midis. Ky pozicion i rampes favorizon edhe shfrytezimin e trupit pasi nga ky punim do te hapen ne te dy krahet galerite e nenkateve.

2.4.6 Kapaciteti prodhues dhe jeta e minieres

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion pasurimin ne fabrike dhe eksportin e koncentratit. Kapaciteti vjetor do te jete rreth 10-000 - 30 000 ton/vit mineral bakri e zinku sipas njoftimit Fitues nga MIE

a. Percaktimi i jetes se minieres

Me sasine e disponueshme te rezervave prej rreth 220 000 ton rezerva gjeologjike, dhe rreth 135 000 ton te nxjerrshme, dhe me shtimin e mundshem te tyre, duke marre nje kapacitet prej rreth 30 000 ton/vit jeta e minieres paraprakisht mund te shkoje rreth 11 vjet.

b. Radha dhe drejtimi i shfrytezimit me grafiket perkates ne vite

Shfrytezimi do te filloje pas hapjes se galerive ne nivelet +800 dhe +760. Sigurisht puna do te filloje me ngritjen e kantjerit per rihapjen e minieres, duke kompletuar me objektet siperfaqesore teknologjike per hapjen e punimeve minerare dhe nxjerrjen e mineralit te bakrit dhe te zinkut, sipas programit te hartuar nga administrata drejtuese e objekteve.

Radha e shfrytezimit te objektit do te jete nga lart poshte, ndersa drejtimi i shfrytezimit nga qendra ne kufi.

2.4.7 Percaktimi i vendit te depozitimit te mineralit, llogaritja e kapacitetit depozitues:

Shoqeria krahas investimeve te tjera qe do te kryeje, do te investoje edhe per rindertimin e bunkerave te cilet do te sherbejne per ngarkimin e mjeteve te transportit. Prodhimi ditore i mineralit te bakrit qe del nga miniera do te ngarkohet direkt nga bunkerat e minieres ne automjete dhe do te dergohet ne fabriken e pasurimit. Sasia e prodhimit ditore do te depozitohet ne bunkerat e mineralit ne siperfaqe. Kapaciteti i bunkerit do te jete per prodhimin e nje dite ose baraz me 115 ton.

Gjithashtu prane bunkerave eshte edhe nje shesh depozitimi me kapacitet prej rreth 3000 ton, i cili do te beje te mundur mos nderprejen e prodhimit per shkak te mungeses se evadimit.

2.4.8 Percaktimi i vendit per depozitimin e sterileve, llogaritja e kapacitetit depozitues

Sterilet e dala ne siperfaqja si rrjedhoje e hapjes se punimeve minerare dhe varferimit (shembje e shkembenjeve te tavanit) do te depozitohen ne vend depozitimin e sterileve te percaktuar ne harten topografike, prane hyrjeve te punimeve (Plani i Rehabilitimit duke mos zone toke buke (ne pergjithesi jane toka jo-produktive per bujqesi). Nisur nga volumi i punimeve minerare qe parashkohet te ringrihen dhe te hapen, prej rreth 4100 ml galer me seksion 10.5 m², parashkohet te nxirren nga nentoka reth 43 000 m³ sterile,

Duke ju shtuar ketyre edhe sterilet qe mund te dalin gjate procesit te seleksionimit nentoke dhe siperfaqe, perafersishte 5% e volumit te prodhimit prej 135 000 x 0.5%= 6750 m³, rezulton se volumi i pergjithshem i serileve qe do te depozitohen ne hyrje te punimeve ehte rreth 50 000 m³

Theksojme se keto sterile jane formacione gjeologjike te zones dhe nuk kane elemente ndotes, kimik.




Figura 7: Percaktimi I sheshit te depozitimit te sterileve.

2.4.9 Ajrimi i minieres

a. Percaktimi i llojit te ajrimit te minieres

Specifike per sektoret e mierva te bakrit ne pergjithesi dhe per ato te Gurthit ne vecanti eshte se bashku me mineralin e bakrit dhe te baker-zinkut ndodhet edhe minerali piritit me permbajtje sqfuri. Ne keto kushte ekziston rreziku i vetndezjes se mineralit ne miniere, prandaj regjimi i ajrimit per keto miniera duhet te jete i drejtuar dhe efektiv.

Sipas llogaritjeve te hollesishme te ajrimit, sipas skemes qe ajri do te hyje nga traverbanku +680 m dhe do te dale ne galerine +860m dhe do te jene ne funksion nga nje oxhak ne nivel.

Pas pefundimit te lidhjes me oxhaqet e trupave te bllokut perkates, nuk nevoitet ajrim lokal per fetat e mesiperme te shfrytezimit, prandaj keto feta parashikohen me lartesi 2 metra

Ne menyre qe lartesi e frontit te punes (ku behet shpimi dhe ngarkimi) te mos jete $3+2 = 5$ metra, por te jete 4 metra, pas pefundimit te fetes se pare te me poshtme me lartesi 3 metra dhe lidhjes se saj me te gjitha oxhaqet e ajrimit te hapura neper mineral nga ortet ne krah te gjysem bllokut, kjo fete e pare me lartesi 3 metra mbushet 1 meter lartesi dhe pastaj vzhdohet me fetat e tjera me lartesi 2 metra, duke patur ne front lartesine 4 metra (shih skemen e shfrytezimit).

Sipas skemes se ajrimit qe pershkruam me siper, Gurthi 3 eshte nje miniere e lehte per ajrim.

Ne baze te llogaritjeve te projektuesit depresioni natyror del te jete 9.35 mm H₂O.

Sidoqofte ne çdo rast perpara futjes ne pune te punetoreve pergjegjesi teknik i turnit duhet te mati parametrat e gjendjes se ajrimit ne fronte e te lejoje hyrjen e puntoreve kur ato jane ne normat e lejuara nga rregullorja perkatese e ajrimit.

2.5 Infrastruktura e nevojshme per realizimin e projektit

Nderkohe per ecuri normale te pergatitjes, shfrytezimit e prodhimit subjekti do te perdore edhe burime te tjera si energji elektrike edhe burime te tjera natyrore, lende djegese per mjetet, ajer per ajrimin ne netoke, uje per shpimet, uje te pishem, inerte si dhe infrastrukture rrugore etj.

Për hapjen dhe shfrytëzimin e mineralit parashikohen të hapet rruge e re nga sheshi aktual i fabrikes se pasurimit Spaç deri ne nivelet e poshteme +760 m dhe te siperm +800 m. Rruga do të shërbejë për lidhjen e minierës në pjesën e poshtëme me fabriken e pasurimit. Rruga do të ketë një pjerrësi 8-12.5 %. Gjerësia e rrugës do të jetë rreth 3 m ndersa gjatësia e rrugës do te jete 3250 m.

Hapja e rruges se aksesit do te kete projekt te vecante dhe nje procedure tjetere miratimi.

Kjo rruge do te sherbeje per aksesin e te dy zonave minerare Gurth 3 dhe Letitna.

Në objekt nuk parashikohen të ndërtohen objekte industriale dhe të shërbimit. Ato do te jene objekte te ndertuara ne fabriken e pasurimit Spaç ku dhe do te perqendrohet gjithe infrastrukture e minieres Gurth 3 dhe Letitnes. Pra nuk parashikohen të ndërtohen objekte të tjera si ambiente, mence –dushe garderobë, pasi per kete qellim do te sherbeje qendra social kulturore e ngritur ne fabriken dhe minieren Spaç.

Gjate fazës fillestare nuk parashikohet të përdoren makineri dhe pajisje të ndryshme të cilat punojnë me energji elektrike, ndërsa më vonë për elektrokompresoret, ndriçimin etj. do të përdoret energjia elektrike, dhe për këtë arsye do të ndërtohet një kabinë elektrike e pajisur me transformator dhe të gjithë aksesorët e nevojshme. Furnizimi me energji elektrike do te behet me lidhje nepermjete linjes elektrike nga fabrika Spaç deri ne hyrjen e punimit +760 m ku dhe do te vendoset kabina elektrike, salla e kompresoreve dhe sheshi industrial i minieres.

Lidhja telefonike e objektit me subjektin do të bëhet me telefona mobile dhe fikse.

Theksojme se kato nevoja nuk do te kene ndonje ndikim ne furnizimin e zones apo impakte te tjera mjedisore.

2.6. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe sigurimi i tyre(materiale ndertimi, uje, energji)

Lëndët e para që do të përdoren për ndërtim jane materialet elektrike dhe hidraulike, lende djegese dhe vajra lubrifikant, uji, beton si dhe pajisje si transformator, aparaturat e ajrimit, lendet plasese (dinamit, kapsolla), shtylla miniere, shtanga, rrjete teli, torket, koka pobiediti, shtylla druri etj. Materialet elektrike do te sherbejne per riparimin e linjes elektrike si dhe per instalimet elektrike ne te gjitha ambjentet e sherbimit edhe ne brendesi te minieres.

Karburanti dhe vajrat do te sherbejne per automjetet e transportit si dhe per eskavatorete. Betoni do te perdoret per betonimin e kanaleve te ujrave te drenazhimit, armatim ne brendesi te minieres si edhe per ndertime te tjera qe mund te lind nevoja. Shtylla miniere, shtanga, rrjete teli, torket, koka pobiediti, shtylla druri do te perdoren per armatimin e minieres.

Te gjitha lendet e para do te sigurohen nga subjekte private te licensuara per tregtimin e tyre.

Uji do te perdoret per shpim dhe me pas do te lihet te denkantoje ne brendesi te minieres dhe te depertoje ne shtresat e nentokes ne gjendje te lire. Sasia e ujit qe do te perdoret do te sigurohet nga ujrat nentokesore qe do te grumbullohen ne brendesi te galerise. Furnizimi me energji elektrike do te behet nepermjet linjes elektrike nga fabrika Spaç deri ne hyrjen e punimit +760 m.

2.7. Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate lidhur me vendodhjen

Lidhur me kete vendodhje eshte zhvilluar nje konkurim publik per dhenien me koncension te vendburimeve ne kete zone , vendodhja e galerive nentokesore te te cilave percaktohen nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

Me ane te marrjes se Njoftimit te Fituesit Nr . 10871 /2 date 19.09.2018 per perftimin e te drejtes per aplikimin e lejes Minerare Zona Minerare 275/9 (Objekti Gurth 3).

2.8. Perdorimi i lendeve te para gjate funksionimit te aktivitetit dhe menyra e sigurimit te tyre

Nisur nga fakti qe ky aktivitet eshte aktivitet shfrytezimi i burimeve natyrore, nuk perdor lende te pare por siguron lende te pare i cili eshte minerali i bakrit. Ky mineral i neshtrohet proceseve te tjera teknologjike deri ne produkt final ne nje instalim pasurimi ne zone.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren gjate kohes se shfrytezimin jane lende djegese, vajra lubrifikant per automjetet e transportit dhe eskavatoret, lëndët plasëse, energji elektrike, uji si edhe ajer për ajrimin e minieres në brendesi.

Lendet e para ndihmese si lenda djegese, vajra lubrifikant dhe lëndët plasëse do te sigurohen nga subjektet private te licenzuar per tregetimin e tyre.

Sasia e ujit qe do te perdoret do te sigurohet nga ujrat nentokesore qe do te grumbullohen ne brendesi te galerise. Furnizimi me energji elektrike do te behet nepermjet linjes elektrike nga fabrika Spaç deri ne hyrjen e punimit +760 m.

4. PERSHKRIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR

4.1. Ndikimet negative ne mjedis gjate fazes se hapjes se galerive (pergatitore)

4.1.1. Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit

Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit lidhen kryesisht me ndryshimet topografike, relievit, peisazhit, rreshqitjes se dherave dhe erozionit.

Gjate fazes se pergatitjes, do te verehen ndryshime ne topografi dhe peisazh te zones minerare pasi ne vendburim do te hapen dy galeri te reja, si edhe paraprakisht do te hapen 2.5 km rruge te reja aksesit qe lidhni keto galeri me fabriken e pasurimit te mineralit te bakrit.

Keto ndryshime nuk do te shtrihen ne gjithë siperfaqen e zones minerare, por jane te lokalizuar pikerisht aty ku do te kryhen punimet per hapjen dhe shfrytezimin e galerisë si edhe pjesa ku do te hapet rruga e re.

4.1.2. Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit

Zona e minieres nuk është shume e pasur me bimësi me përjashtim të disa zonave barishteve dhe shkureve të ulta dhe drureve te larte si pisha. Objekti i aktivitetit te shfrytezimit eshte nentoke por ndikimi kryesisht do te vije si pasoje e punimeve mbi siperfaqen e tokes per hapjen e rrugeve te reja te aksesit si edhe hapjen e dy galerive. Per pasoje ne pjesen ku do te hapen galerite dhe rruget e reja do te kemi heqje te mbuleses bimore si edhe shqetesim te faunes nga zhurmat e gjeneruara nga mjetet e punes.

4.1.3. Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Shkarkimet ne uje

Gjate fazes pergatitore të galerisë uji i perdorur per shpim si dhe ujerat nentokesore do te lihen te dekantojne ne brendesi te minieres dhe me pas te depertojne ne gjendje te lire ne shtresat e nentokes. Theksojme se ujrat nentokeser qe do te perdoren per shpim kane te njejten permbajtje te mineraleve me galerine pasi rrjedhin ne brendesi te galerive dhe nuk konsiderohen si ndotes te shtresave te nentokes. Gjithashtu shtresat e nentokes duke pasur veti filtruese shume te mira per ujrat, do te ndikojne pozitivisht ne permiresimin e cilesis se ketyre ujra gjate depertimit ne shtresat e netokes.

Shkarkime te tjera ne uje gjate procesit te pergatitjes mund te vijne si pasoje e derdhjes aksidentale te lendes djegese dhe vajrave lubrifikues nga ndonje avari e automjeteve, hedhje e masave te dherave dhe sterileve te gjeneruara nga hapja e rrugeve te reja dhe galerive ne perroin e Plagezes.

Shkarkimet ne ajer

Shkarkimet ne ajer vijne si pasoje e pluhurit qe do te krijohet gjate procesit te germimeve per hapjen e rrugeve te reja dhe galerive, gjate procesit te ngarkimit, shkarkimit dhe transportit te dherave dhe sterileve me mjetet perkatese per ne venddepozitim e percaktuar per kete qellim, si edhe nga gazet qe clirohen nga mjetet qe perdorin lende djegese. Shkarkime te tjera ne ajer kemi edhe nga procesi i ajrimit te galerise gjate fazes se hapjes deri ne trupat e mineralit te bakrit. Ajri qe del nga galeria permban sasi te vogla te pluhurit dhe gazeve qe clirohen nga perdorimi i mjeteve te punes dhe lendeve plasese ne brendesi te galerise.

Shkarkimet ne toke

Shkarkimet ne toke vijne si pasoje e depozitimit te dherave dhe masave sterile qe dalin gjate fazes pergatitore. Masat e dherave dhe sterileve te gjeneruara nga proceset e germimeve per hapjen e rrugeve te reja te aksesit dhe hapjen e galerive do te sherbejne per sistemim dhe mbushje ne mjedise te cilat do te sherbejne si shesh depozitimi te mineralit por edhe te pjeseve te tjera ku do te kryhen punime.

4.1.4. Ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit, dhe peisazh si mineralet, pyjet, burimet ujore

Aktiviteti i shfrytezimit te pasurive nentokesore nuk shoqerohet me ndikime negative shtese ne cilesine e mjedisit, peisazh , uje, toke dhe ajer.

4.1.5. Ndikimet sociale te projektit, ndryshimi i perdorimit te tokes, ndikimet nga zhurmat, pluhuri, perdorimi i burimeve natyrore

Punimet sipërfaqesore per hapjen e rrugeve te aksesit dhe te dy galerive te zones minerare Gurth 3 do te kryhen ne sipërfaqen e zones minerare Letitna. Si rrjedhim ndikimet do te verehen ne sipërfaqen e zones minerare Letitna.

Ky projekt nuk kerkon te kemi spostim te zonave te banuar apo krijimin e zonave te reja te banimit pasi zona minerare eshte zone e pa banuar. Zonat e banuara kane distance te konsiderueshme me zonen ku do te zhvillohet projekti dhe nuk do te ndikohen nga zhurmat, vibracionet dhe pluhurat qe do te gjenerohen gjate proceseve te ndryshme te punes. Ndikimi ne popullsine e zonave perreth eshte pozitiv pasi do te permirsoje infrastrukturen rrugore. Gjithashtu do te rrise te ardhurat mujore per ta pasi fuqia punetore do te ziguohet nga banoret e zoneve perreth.

Theksojme se ndikimet e permendura ne kete pike (Pika 4.2) do te verehen ne sipërfaqen e zones minerare nr 275/6, objekti Letitna per arsye se punimet sipërfaqesore per hapjen e rrugeve te aksesit dhe hapjen e galerive per shfrytezimin e zones minera nr. 275/9, objekti Gurth 3 do te kryhen e sipërfaqen e kesaj zone minerare (zona minerare nr 275/6, objekti Letitna).

4.2. Identifikimi i ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës së shfrytëzimit

4.2.1. Ndikimet e mundshme mjedisore në nëntokë dhe proceset sipërfaqësore të tokës

Gjatë fazës së shfrytëzimit me galeri shkëmbi tokëformues me interes mineralar do të gërmohet për nxjerrjen e mineralit. Ndikimet e mundshme negative lidhen me ndryshimet në strukturën e nëntokës dhe dëmtimin e saj për llogari të nxjerrjes së mineralit. Si pasojë e plasjeve dhe gërmimeve struktura e nëntokës mund të pësojë çarje ose shëmbje.

Por sipas raportit teknik të paraqitur nga kompania, në seksionet e planifikuar për shfrytëzim nuk janë shfaqur shembje dhe nuk krijohen zona rreziku në asnjë pikë të fushës minerare.

Sa i takon sipërfaqes së tokës, do të ketë ndikime nga proceset mekanike të lëvizjes së makinerive.

Ndikime të tjera në sipërfaqen e tokës të lidhura me këtë fazë janë *ngjeshja e tokës* nga lëvizja e makinerive, *erozioni i tokës* përreth zonës së hyrjes së galerive dhe përgjatë rrugëve në zonë, *ndotja* e tokës nga lubrifikantët e makinerive.

Keto lloje ndikimesh do të verehen në sipërfaqen e zonës minerare Letitna pasi hyrja për në galeritë dhe rruga e aksesit do të jenë brenda sipërfaqes së kesaj të fundit.

Për shmangien dhe parandalimin e errozimit, shembjes së sipërfaqes dhe vithisjeve të ndryshme, në projekt është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë në sipërfaqes që i takon ndërtimit të minierës.

4.2.2. Ndikimet e mundshme negative në ajër

Pluhuri dhe gazet - proceset që mund të shkaktojnë pluhura në mjedis janë ventilimi i galerive nëntokësore. Agjentët atmosferikë si era mund të ngrenë sasi të konsiderueshme pluhuri nga kantieret e minierave prandaj në mot të thatë dhe me re nevojitet të spërkatën sheshet hyrëse të galerive apo rrugët e brendshme.

Gjatë punimeve në nëntokë dhe shpërthimeve krijohen gaze si CO_x dhe NO_x të cilët mund të kenë efekte negative dhe me pasojë sidomos në jetën e minatorëve. Megjithatë nuk parashikohen çlirime të mëdha gazesh nga operacionet nëntokë, megjithatë sistemi i aspirimit dhe ventilimit të gazeve dhe pluhurave duhet të funksionojë rregullisht.

Zhurma dhe vibracionet – Burimi kryesor për këtë lloj ndikimi janë shpërthimet, por shpërthimet nuk vlerësohet të kenë ndikime thelbësore së pari sepse janë operacione që kryhen nëntokë dhe të kontrolluara dhe së dyti sepse qendrat e banuara janë larg.

4.2.3. Ndikimi në biodiversitet

Duke qenë se faza e shfrytëzimit lidhet kryesisht me aktivitetin nëntokësor, edhe ndikimet kryesore në biodiversitet në këtë fazë lidhen me faunën. Në këtë rast ndikimet që do të shfaqen janë shqetësim i llojeve të ndryshme që popullojnë zonën për shkak të zhurmave dhe pluhurit. Ky ndikim do të bëhet shkak i mbajtjes larg të komuniteteve të caktuara.

Pluhuri do të jetë një shqetësim edhe për bimësinë e pakët të zonës. Ndërsa dëmtim fizik të saj siç është prerja në këtë fazë nuk do të kemi.

4.2.4. Ndikimet e mundshme negative në ujë

I vetmi trup ujor sipërfaqësor që mund të ndikohet nga aktiviteti mineral është perroi i Plagezes i cili rrjedh në të majtë dhe poshtë galerive nëntokësore në pjesën perëndimore të zonës minerare ku do të ndërtohet edhe rruga e aksesit dhe vendëpozitimi i sterileve. Siç është përmendur më sipër largimi i ujërave të minierës bëhet me vetërrjedhje. Ujrat do të lihen të dekantohen në brendësi të minierës dhe me pas të depertojnë në gjendje të lirë në shtresat e nëntokës. Shfrytëzimi nuk ka operacione teknologjike, por ujërat mund të ndikohen nga grimcat dhe pluhuri mineral që do të gjenerohen nga proceset e shpimit dhe shpërthimit në galeri. Bashkëveprimi i ujit me grimcat e mineralit, sidomos me sulfidin që gjendet në zonën minerare mund të shkaktojë efektin e zverdhjes së masës ujore dhe rritjen e aciditetit të ujit.

Thëksojmë se ujrat nëntokësorë që do të përdoren për shpim kanë të njëjtën përmbajtje të mineraleve me galerinë pasi rrjedhin në brendësi të galerive dhe nuk konsiderohen si ndotës të shtresave të nëntokës. Gjithashtu shtresat e nëntokës duke pasur veti filtruese shumë të mira për ujrat, do të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së ketyre ujërave gjatë depërimit në shtresat e nëntokës.

4.2.5. Ndikimet në shëndetin e punonjësve

Probabiliteti i ndodhjes së aksidenteve me pasojë në mjedis por edhe humane dhe ekonomike gjatë zhvillimit të projektit është në varesë të drejtëpërdrejtë me masat që do të merren dhe zbatimin e tyre.

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin janë:

- ✚ Shëmbja e Galerise si pasoje e punimeve dhe shperthimeve te pakontrolluara.
- ✚ Renia e zjarrit ne ambjentet e punes.
- ✚ Demtimi i punonjesve gjate punes.

Per te shmangur ndodhjen e aksidenteve gjate procesit te pergatitjes dhe shfrytezimit te minieres inxhinieret perkates kane planifikuar rradhen dhe menyren e kryerjes se punimeve. Per kryerjen e ketyre punimeve subjekti do te siguroje te gjitha mjetet e nevojshme te punes si edhe do te punesoj staf teknik dhe te specializuar. Gjithashtu do te kryhen edhe trajnime te metejshme per te informuar punonjesit lidhur me rreziqet e ndodhjes se aksidenteve gjate kryerjes se punimeve si edhe masat paraprake qe duhet te zbatohen me perpikmeri te shmangur ose minimizuar probabilitetin e ndodhjes se ketyre aksidenteve. Kompania ka marre masat per realizimin e monitorimeve ne ambientet e punes me ane te nje plan monitorimi te vecante per qellim sigurie.

5. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

Zhvillimi i projektit ne zonen minerare te dhene per shfrytezim nuk ka ndikime pasuese mjedisore. Ne territorin e zones minerare nuk ka qendra te banuara, si rrjedhoj nuk eshte e nevojshme spostimi apo ndertimi i zonave te reja te banimit. Zonat me te aferta te banimit kane distance te konsiderueshme nga zona minerare dhe nuk do te ndikohen negativisht nga punimet qe do te kryhen. Hapja e rruges se aksesit dhe vendepozitimi sterileve ne territorin e Mirdites ndodhet ne nje distance relativisht te madhe nga shtepia me e afert e fshatit Gurth Spac.

Zhvillimi i ketij projekti pervec te tjerave do te kete ndikim pozitiv ne uljen e papunesise dhe permiresimit te infrastruktures rrugore. Fuqia punetore do te sigurohet nge banoret e zonave perreth dhe kjo do te rrise te ardhurat mujore per familjet e tyre. Permiresimi dhe mirembajtja e infrastruktures rrugore do te beje te mundur lidhjen e ketyre zonave me akset kryesore nacionale. Gjithashtu ky projekt do te siguroje nje shfrytezim eficient te mineralit te bakrit. Nje ndikim tjeter pozitiv i ketij projekti eshte se siguron te ardhura ne buxhetin e shtetit nepermjet sistemit te taksave

6. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Per zhvillimin e nje projekti nje rendesi te madhe ka edhe zbatimi i politikave per mbrojtjen e mjedisit. Ne kuader te kesaj, zhvillimi i projekteve do te shoqerohet me planin e masave ku perfshihen masa dhe veprime konkrete per mbrojtjen edhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.

6.1. Masat për zbutjen e ndikimeve gjatë fazës përgatitore dhe shfrytëzimit të galerive nentokesore

- ✚ Ndertimi i depozitave te dekantimit dhe kontrolli periodik i cilesise se ujrave, nepermjet kryerjes se analizave perkatese per te pare nese keto ujra jane te ndotura kimikisht, perpara se te derdhen ne perrenjt e zones.
- ✚ Sasia e dherave dhe sterileve qe gjenerohen gjate proceseve te pergatitjes dhe shfrytezimit te minieres do te perdoret per mbushjen e minieres, mirembajtjen e rrugeve dhe rehabilitimin e siperfaqeve te demtuara pas perfundimit te shfrytezimit te minieres.
- ✚ Kontrolli i vazhdueshem i gjendjes teknike te automjeteve te shfrytezimit dhe transportit, si edhe ne rast se konstatohen difekte ne to, do te behet riparimi i menjehershem i tyre.
- ✚ Fikja e ketyre mjeteve ne rastet kur nuk eshte i nevojshem perdorimi i tyre.
- ✚ Shmangia e renies se borieve te automjeteve kur nuk eshte e nevojshme.
- ✚ Kujdesi i shofereve gjate levizjes dhe zhvendosja e kafsheve ne rast aksidenti.
- ✚ Percaktimi i vendeve te pershtateshme per magazinimin e lendes djegese dhe vajrave lubrifikant.
- ✚ Nese konstatohen zona te ndotura si pasoje e rjedhjes aksidentale dhe avarive mekanike merren masa te menjhershme per pastrimin e tokes.
- ✚ Hapja e kanaleve grumbulluese ne siperfaqe per te ulur gerryerjen e tokes nga ujrart e rreshjeve sidomos kur ato jane intesive.
- ✚ Kryerja e punimeve dhe shperthimeve me lende plasese ne menyre te kontrolluar per te shmangur vibracione te forta apo plasaritje qe me pas mund te sjellin rreshqitje masive te tokes.
- ✚ Te zbatohet rigorozisht projekti teknik i cili ka te percaktuar menyren se si do te operohet ne miniere ne menyre qe te parandaloje erozionin dhe shembjen e galerise.
- ✚ Sasia e mbetjeve te gjeneruara si pasoje e aktivitetit njerzor te punonjesve do te grumbullohet ne koshat e vendosur per kete qellim dhe do te transportohet per ne veddepozitimin e mbetjeve urbane te zones.
- ✚ Lagia me uje e zonave ku do te kryhen germimet si edhe e sheshit ku do te depozitohet sterili per te shmangur gjenerimin e pluhurit.
- ✚ Levizja e automjeteve me shpejtesi te kufizuar per te shmangur gjenerimin e pluhurit.
- ✚ Percaktimi i pikave ose i shesheve per depozitimin e dherave dhe sterileve qe gjenerohen ne menyre qe mos te kemi perhapje kaotike te pakontrolluar te tyre brenda zones minerare.
- ✚ Vendosja e koshave te grumbullimit te mbetjeve qe gjenerohen nga aktiviteti njerzor i punonjesve per te shmangur hedhjen dhe perhapjen kaotike te tyre ne mjediset perreth.

6.2. Masat për sigurimin teknik ne pune

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar dhe ne menyre te veçante gjate kryerjes se punimeve me lende plasese, subjekti do te mbaje parasysh qe problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe do te marrin vleresim paresor ne veprimtarine tone te perditeshme.

Para se gjithash, ne te gjitha operacionet, do te punesohen specialiste me eksperience pune ne kryerjen e proceseve te ndryshme te karakterit minerar .

Drejtuesi teknik i punimeve, para fillimit te punes dhe gjate saj, do te zbatoje rregullat dhe normat e percaktuara ne:

1. Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karierat te Vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise Nxjerrrese dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrit Nr 132, date 07.04.1999 , mbeshtetur ne nenin 17 te Ligjit Minerar Shqipetar Nr 7796 date 17.02.1994 dhe te botuar ne vitin 2001
2. Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per Punet me Lende Plasese ne Miniera dhe Naftë te hartuar nga ITNP te Mineraleve dhe te botuar me muajin Mars te vitit 2002. Rishikuar ne vitin 2004 dhe miratuar me VKM Nr 533 date 08/07/2005 dhe botuar ne fletoren zyrtare Nr 58 te dates 19/07/2005.

Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit privat, do te zbatohen ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes , i cili duhet te permbaje:

- ✚ Plan organizimi i punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve;
- ✚ Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- ✚ Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik dhe azhornimin e sakte te punimeve minerare te cdo lloji per te cilat subjekti ka marre leje shfrytezimi;
- ✚ Rradha e kryerjes do te percaktohet hollesisht ne planin e masave tekniko-organizative dhe do te miratohete nga pronari i firmes;
- ✚ Ne kete plan tekniko-organizativ, masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor;
- ✚ Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore , ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet;
- ✚ Punonjesit qe do te punojne ne miniere per berjen e minave dhe zjarretaret direkt ose te nenkontratuat do te testohen cdo tremujor kundrejt firmes;
- ✚ Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese te rrezimit e kromi dhe sterilit ne frontin e nenkatit apo ballin e punimit , te hartuara prapakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit;
- ✚ Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve te transportit te brendshem ne miniere;
- ✚ Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese, gjate kryerjes se punimeve minerare qe do te sherbejne per hapjen dhe pergatitjen e vendburimit , te parashikuara ne pasaportat e hartuara prapakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit;
- ✚ Do të zbatohet nje regjim i rreptë ne procesin e pergatitjes se fitilit ndezes dhe të kontrollit konform Rregullores se Teknikës se Sigurimit Për Punet me Lende Plasëse Ne Miniera dhe Naftë dhe perkatësisht nenet 251-256, faqe 85-87;
- ✚ Do të zbatohet nje regjim i rreptë ne procesin e pergatitjes se fishekut të zjarrit, dhe mbushjes se minave konform Rregullores se Teknikës se Sigurimit Për Punet me Lende Plasëse Ne Miniera dhe Naftë perkatësisht nenet 266-269, faqe 109-113;
- ✚ Ne rastin e shperthimit me kapsolla dhe fitil të zakonshme do të zbatohet Rregullorja e Teknikës se Sigurimit Për Punet me Lende Plasëse ne Miniera dhe Naftë perkatësisht nenet 270-278;

- ✚ Ne rastin e shperthimit me kapsolla elektrike do të zbatohet Rregullorja e Teknikës së Sigurimit Për Punët me Lende Plasëse në Miniera dhe Naftë (Fletore zyrtare Nr 58 të datës 19/07/2005.) përkatësisht nenet 287-307;
- ✚ Do të zbatohet një regjim i rreptë në procesin e likuidimit të birave të pa plasuar konform Rregullores së Teknikës së Sigurimit Për Punët me Lëndë Plasëse Në Miniera dhe Naftë (Fletoren zyrtare Nr 58 të datës 19/07/2005).

7. MONITORIMI MJEDISOR

7.1. Programi i monitorimit

Në përgatitjen e programit të monitorimit mjedisor është marrë në konsideratë mundësia e realizimit të një monitorimi realist të elementëve me ndikim në mjedis. Sa i takon vetëmonitorimit kompania duhet të vëzhgojë ata elementë që realisht mund të maten, regjistrohen dhe komunikohen në organet e administrimit të mjedisit.

Të dhënat cilësore, sipas tabelës do të hidhen në një regjistër që administrohet nga vetë kompania dhe do të dorëzohen në DRM-në e qarkut sa herë është e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Më poshtë jepen disa indikatorë të cilët duhen monitoruar për të vlerësuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore të projektit.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1.	Monitorim i zhurmave dhe pasojave të plasjeve në minierë	Vazhdueshëm
2.	Monitorimi i biodiversitetit në zonën rreth objektit të shfrytëzimit	Vazhdueshëm
3.	Monitorimi i cilesise se ujerave te galerive	Vazhdueshëm
4.	Monitorimi i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për rrjedhje dhe ndotje	Vazhueshëm
5.	Monitorim i faktorëve që shkaktojnë rreziqe natyrore dhe humane	Vazhdueshëm

Parametrat e rekomanduar të monitorimit të cilesise se ujit te galerive

Parametrat e rekomanduar të monitorimit të cilesise se ujit te galerive	<p>pH</p> <p>lendet ne pezulli</p> <p>arsenik</p> <p>kadmium</p> <p>bakri</p> <p>plumbi</p> <p>merkuri</p> <p>zinku</p> <p>hekuri</p>
--	---

Të dhënat që do të përfitohen nga monitorimi i parametrave të mësipërm do të shërbejnë për të:

- Përmirësuar/korrigjuar masat e marra për mbrojtjen e mjedisit;

- Vlerësuar efektivitetin e masave të marra për kontrollin e ndikimeve dhe mbrojtjen e mjedisit (performancë mjedisore);
- Vlerësuar përputhshmërinë me kërkesat e legjislacionit mjedisor për mbrojtjen e mjedisit.

Interpretimi i një gjendje të caktuar mjedisore duhet bërë në lidhje të ngushtë me fazën në të cilën gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se një gjendje e përkeqësuar e mjedisit në një fazë të caktuar të zbatimit e cila është fazë tranzitore nuk është tregues absolut i realizimit të objektivave të projektit.